3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;
- Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Ish - Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë – (pranë “Asllan Rusi”)	1 copë			
2.	Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (pranë Kompleksit “Malajzian”)	1 copë			
3.	Terminali i Autobuzave të Juglindjes – (pranë qendrës tregtare “TEG”)	1 copë			
4	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”)	1 copë			
5	Sheshparkimi i automjeteve Tirana	1 copë			

	Parking – (Pallati i Sportit “Asllan Rusi”)				
6	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).	1 copë			
7	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Frederik Shopen”).	1 copë			
8	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).	1 copë			
9	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).	1 copë			
10	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).	1 copë			
11	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Bulevardi i Ri”)	1 copë			
12	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Kopshti Zoologjik”)	1 copë			
13	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor Tirana Parking (Sheshi “7 Xhuxhat”)	1 copë			
14	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor Tirana Parking (Sheshi “7 Xhuxhat”)	1 copë			
15	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor Tirana Parking (Sheshi “Skënderbej”)	1 copë			
16	Rruga e Barrikadave	3 copë			
17	Rruga Ferit Xhajko	5 copë			

18	Rruga Kont Urani	2 copë			
19	Rruga e Bogdanëve	5 copë			
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Mirëmbajtje e kanalizimeve, pusetave, pompave si më poshtë:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	Ish - Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë – (pranë “Asllan Rusi”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
2	Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (pranë Kompleksit “Malajzian”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
3	Terminali i Autobuzave të Juglindjes – (pranë qendrës tregtare “TEG”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
4	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
5	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Pallati i Sportit “Asllan Rusi”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit

6	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
7	Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Frederik Shopen”).	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
8	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
9	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
10	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
11	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Bulevardi i Ri”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
12	Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Kopshti Zoologjik”)	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimit
13	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë

	Tirana Parking (Sheshi "7 Xhuxhat")				pune – afati i lëvrimin
14	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor Tirana Parking (Sheshi "7 Xhuxhat")	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin
15	Kasa Automatike - Parkingu Nëntokësor Tirana Parking (Sheshi "Skënderbej")	copë	1	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin
16	Rruga e Barrikadave	copë	3	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin
17	Rruga Ferit Xhajko	copë	5	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin
18	Rruga Kont Urani	copë	2	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin
19	Rruga e Bogdanëve	copë	5	Sipas kërkesave të AK.	1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës – ofrimi i shërbimit/ 60 ditë pune – afati i lëvrimin

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Tirana Parking si institucion varësie i Bashkisë Tiranë, i krijuar bazuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.49, datë 11.11.2015 për “Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim”, Tirana Parking ka për detyrë menaxhimin e parkimit Publik me dhe pa Pagesë mbi dhe nën tokë në qytetin e Tiranës, ku përfshihen sheshparkimet e mbyllura, терминаlet e autobuzave, parkimet nëntokësore si dhe rrugët e destinuar me tarifim.

Hapësirat e mësipërme të destinuar për parkim të mbyllur menaxhohen me anë të sistemeve të parkimit të instaluar në to, të cilat janë të tipit “**CAME PARKARE PKE**”.

Këto sisteme parkimi kanë “*software*” e tyre “**Lince**” për të kryer funksionimin e sistemit të parkimit si dhe lidhjen me serverin multiparking i cili bën menaxhimin simultan të të gjitha sistemeve të parkimit individuale.

Këto sisteme parkimi janë instaluar gjatë periudhave të ndryshme të administrimit të hapësirave të destinuar për parkim nga ana e institucionit, dhe për këtë arsye kanë versione të “**Lince**” dhe integrimin e fiskalizimit të vitit të kaluar të instaluar në to.

Konkretisht versionet e “**Lince**” të cilët janë instaluar në sistemet e parkimit si më poshtë:

1. Ish - Terminali i Autobuzave Ndërkombëtarë – (pranë “Asllan Rusi”)
2. Terminali i Autobuzave të Jugut dhe Veriut – (pranë Kompleksit “Malajzian”)
3. Terminali i Autobuzave të Juglindjes – (pranë qendrës tregtare “TEG”)
4. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (“Diga e Liqenit”)
5. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Pallati i Sportit “Asllan Rusi”)
6. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Selman Stermasi”).
7. Sheshparkimi i automjeteve Tirana Parking – (Sheshi “Frederik Shopen”).
8. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Italia”).
9. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “7 Xhuxhat”).
10. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Skënderbej”).
11. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Bulevardi i Ri”)
12. Parkingu Nëntokësor Tirana Parking – (Sheshi “Kopshti Zoologjik”)

Këto versione të “*software*” duhet patjetër të përditësohen pasi versionet e fundit kanë përmirësime në siguri, performancë dhe stabilitet, gjithashtu përshtatshmëri më të lartë në lidhjen me serverin multiparking.

Gjithashtu, bazuar në Vendimin Nr.239, datë 20.3.2020 “Për Kërkesat Teknike dhe Funksionale të Zgjidhjes Softwareike për Procedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Procedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-Ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” nevojitet që versioni i përditësuar i “*software*” të jetë i fiskalizuar në mënyrë që të kryhet procedura e faturimit dhe fiskalizimit.

Përveç sistemeve të parkimit në sheshparkimet e mbyllura institucioni Tirana Parking posedon dhe 15 (pesëmbëdhjetë) copë pajisje të tipit “Parkimetër Smart me Modul Pagese me Monedhë” për vjeljen e tarifës së parkimit në rrugë, të instaluara konkretisht në rrugët:

Rruga e Barrikadave
Rruga Ferit Xhajko
Rruga Kont Urani
Rruga e Bogdanëve

Këto parkimetra janë të brandit “AD.EL SRL” dhe kanë software të zhvilluar nga kjo kompani.

Këto versione të “software” të instaluara në secilin parkimetër duhet patjetër të përditësohen pasi versionet e fundit kanë përmirësime në siguri, performancë dhe stabilitet, gjithashtu përshtatshmëri më të lartë në lidhjen me serverin multiparking.

Gjithashtu, bazuar në Vendimin Nr.239, datë 20.3.2020 “Për Kërkesat Teknike dhe Funksionale të Zgjidhjes Softwareike për Procedurën e Faturimit dhe të Fiskalizimit si dhe Procedurën e Kriteret për Regjistrimin e Prodhuesve e të Mirëmbajtësve të Zgjidhjeve Software-Ike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 16, të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” nevojitet që versioni i përditësuar i “software” të jetë i fiskalizuar në mënyrë që të kryhet procedura e faturimit dhe fiskalizimit.

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 3, datë 20.01.2020, si dhe akteve nënligjore përkatëse, Tirana Parking sh.a., si tatimpagues që kryen transaksione me dhe pa para në dorë, ka detyrimin ligjor të fiskalizojë çdo faturë të lëshuar dhe ta raportojë atë në kohë reale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Për përmbushjen e këtij detyrimi, është e domosdoshme integrimi i sistemit ekzistues të parkimit "Lince" dhe “Ad.El” me një sistem software të certifikuar fiskalizimi, i gatshëm dhe funksional, i cili do të ofrohet dhe mirëmbahet nga operatori i shërbimit për një periudhë njëvjeçare.

Objekti kryesor i shërbimit

Objekti i këtij kontrati është ofrimi, integrimi dhe mirëmbajtja për një periudhë 1 (një) vjeçare të një sistemi software fiskalizimi të gatshëm dhe të certifikuar, i cili do të integrohet me sistemin e parkimit "Lince" dhe “Ad.El”, në mënyrë që çdo transaksion i kryer në sistemin e parkimit të fiskalizohet automatikisht dhe në kohë reale, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Sistemi i fiskalizimit duhet të jetë i zhvilluar, i testuar dhe i certifikuar para fillimit të kontratës. Operatori i shërbimit do të kryejë konfigurimin, integrimin me sistemin "Lince" dhe "Ad.El", vënien në punë, testimin e plotë dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme gjatë gjithë periudhës kontraktuale.

Kuadri ligjor dhe rregullator

Sistemi i fiskalizimit duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në aktet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 3, datë 20.01.2020
- Udhëzimi Nr. 16, datë 03.04.2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5, datë 23.02.2021 dhe Udhëzimin Nr. 27, datë 31.12.2021
- Udhëzimi Nr. 20, datë 01.06.2020 "Për elementet bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese"
- Udhëzimi Nr. 24, datë 16.06.2020 "Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike"
- VKM Nr. 239, datë 20.03.2020 "Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit, si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike"
- VKM Nr. 431, datë 03.06.2020 "Për platformën qendrore të faturave"
- VKM Nr. 220, datë 12.03.2020 "Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve"
- Specifikimet teknike dhe funksionale të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, versioni i fundit në fuqi, duke përfshirë dokumentet "Fiscalization Service – Technical" dhe "Fiscalisation Service – Functional"
- Çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor të nxjerrë nga autoritetet kompetente shqiptare gjatë periudhës së kontratës, i cili ndikon në procesin e fiskalizimit

Kërkesat funksionale të sistemit të fiskalizimit

Sistemi i ofruar duhet të mbulojë tërësinë e funksionaliteteve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar për fiskalizimin e transaksioneve të Tirana Parking sh.a. Në veçanti, sistemi duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Fiskalizimi i transaksioneve në kohë reale

Sistemi duhet të gjenerojë dhe të transmetojë automatikisht në kohë reale te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mesazhet XML për çdo transaksion të kryer nëpërmjet sistemit "Lince". Procesi teknik i fiskalizimit ndiqet sipas hapave të mëposhtëm:

1. Sistemi "Lince" dhe "Ad.El" transmeton të dhënat e transaksionit (faturës) te sistemi i fiskalizimit nëpërmjet API-t të integrimit.
2. Sistemi i fiskalizimit gjeneron automatikisht NSLF-në (Numrin Sekuencial të Lirë të Faturës) – numërim i brendshëm sekuencial unik për çdo faturë – dhe nënshkruan faturën dixhitalisht me certifikatën elektronike të tatimpaguesit.
3. Sistemi dërgon mesazhin XML të nënshkruar drejt serverit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas specifikimeve teknike zyrtare (FiscalizationDataService).
4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve verifikon faturën dhe i kthen sistemit NIVF-në (Numrin Identifikues të Veçantë të Faturës) si konfirmim të pranimit dhe regjistrimit të suksesshëm të faturës.

5. Sistemi gjeneron automatikisht kodin QR i cili përfshin NIVF-në dhe të dhënat bazë të faturës, duke mundësuar verifikimin e saj nga konsumatori ose nga autoritetet tatimore nëpërmjet platformës qendrore të faturave ose aplikacionit përkatës.

b) Menaxhimi i NSLF dhe NIVF

Sistemi duhet të menaxhojë me saktësi gjenerimin e NSLF-së dhe marrjen, ruajtjen dhe asocimin e NIVF-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për çdo faturë të lëshuar. Sistemi duhet të ruajë historikun e plotë dhe të garantojë unitetin dhe integritetin e çifteve NSLF/NIVF gjatë gjithë periudhës kontraktuale dhe pas saj.

c) Llojet e faturave të mbështetura

Sistemi duhet të mbështesë lëshimin e të gjitha llojeve të faturave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar për aktivitetin e Tirana Parking, duke përfshirë:

- Fatura tatimore me para në dorë (cash) – për pagesat e kryera direkt në pikat e arkëtimit të parkingut
- Fatura tatimore pa para në dorë (noncash) – për pagesat e kryera nëpërmjet kartave bankare, transfertave ose mjeteve të tjera elektronike pagese
- Fatura korigjuese – për korigjimin e faturave të gabuara ose anulimin e transaksioneve, sipas procedurës së parashikuar ligjore, duke referuar NSLF-në e faturës origjinale

d) Funkionimi në modalitet offline

Në rast ndërprerjeje të lidhjes me internetin, sistemi duhet të vazhdojë të lëshojë fatura pa ndërprerë shërbimin e parkimit. Faturat e lëshuara gjatë modalitetit offline ruhen të sigurta lokalisht dhe fiskalizohen automatikisht sapo të rivendoset lidhja me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, brenda afateve të parashikuar nga neni 18 i Ligjit Nr. 87/2019. Sistemi duhet të njoftojë operatorin me mesazh të qartë për çdo ndërprerje dhe për statusin e sinkronizimit të faturave të pafiskalizuara.

e) Gjenerimi i kodit QR dhe printimi i faturës

Çdo faturë e lëshuar dhe e fiskalizuar duhet të përmbajë kodin QR të gjeneruar sipas specifikimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili mundëson verifikimin e vlefshmërisë së faturës nëpërmjet platformës qendrore të faturave. Sistemi duhet të mbështesë printimin e faturës me të gjitha elementet e detyrueshme ligjore të parashikuara nga Udhëzimi Nr. 16, datë 03.04.2020, duke përfshirë NSLF-në, NIVF-në, kodin QR, të dhënat e tatimpaguesit, shënimin e llojit dhe mënyrës së pagesës, si dhe normën dhe shumën e TVSH-së.

Kërkesat teknike të sistemit dhe integritetit me "Lince" dhe "Ad.El"

Integrimi i sistemit të fiskalizimit me software-in "Lince" dhe "Ad.El" do të realizohet nëpërmjet API-t (Application Programming Interface) të ekspozuar nga sistemi i fiskalizimit. Operatori i shërbimit është i vetëm përgjegjës për ofrimin e dokumentacionit të plotë teknik të API-t dhe për bashkëpunimin me ekipin teknik të "Lince" dhe/ose CAME PARKARE dhe "Ad.El" për realizimin teknik të integritetit.

Kërkesat teknike kryesore të sistemit dhe API-t janë:

Kërkesa teknike Përshkrim

Protokolli Web Services (SOAP/XML) ose RESTful API, sipas specifikimeve teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (FiscalizationDataService)

Formati i mesazheve XML, i strukturuar sipas skemat zyrtare të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Autentifikimi Certifikatë elektronike e vlefshme e lëshuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit)

Nënshkrimi dixhital Çdo mesazh XML (faturë) duhet të nënshkruhet dixhitalisht sipas standardit XMLDSig, me certifikatën elektronike të tatimpaguesit

Enkriptimi TLS për të gjitha komunikimet me serverin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Kodi QR Gjenerim automatik sipas formatit të specifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, i verifikueshëm në platformën qendrore të faturave

Modaliteti offline Ruajtje lokale e sigurt e faturave gjatë ndërprerjeve dhe sinkronizim automatik pas rivendosjes së lidhjes, brenda 48 orëve

API integrimi API e dokumentuar plotësisht për integrimin me sistemin "Lince" dhe "Ad.El", me mbështetje teknike nga operatori

Certifikimi i sistemit

Sistemi i fiskalizimit i ofruar nga operatori duhet të jetë, para fillimit të shërbimit:

- I certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe AKSHI si zgjidhje software-ike e fiskalizimit, në zbatim të VKM Nr. 239, datë 20.03.2020 dhe rregullores së përbashkët të certifikimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe AKSHI.

- I listuar në regjistrin zyrtar të subjekteve të certifikuara të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në faqen zyrtare www.tatime.gov.al.

Tirana Parking sh.a. do të jetë përgjegjëse për marrjen dhe rinovimin në kohë të certifikatës elektronike nga AKSHI, nëpërmjet portalit e-Albania, e cila do të përdoret nga sistemi i fiskalizimit për nënshkrimin dixhital të faturave. Certifikata elektronike është e lidhur në mënyrë unike me Tirana Parking sh.a. si entitet dhe mund të përdoret për të gjitha pikat e fiskalizimit të kompanisë. Operatori i shërbimit do të asistojë Tirana Parking sh.a. në procesin e konfigurimit të certifikatës në sistem.

Vënia në punë, testimi dhe kalimi në prodhim

Operatori i shërbimit duhet të kryejë konfigurimin, integrimin, testimin e plotë dhe vënie në punë të sistemit të fiskalizimit brenda **60** (gjashtëdhjetë) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kontratës. Gjatë kësaj periudhe do të kryhen:

- Konfigurimi i sistemit të fiskalizimit me të dhënat e Tirana Parking sh.a. (NIPT, certifikatë elektronike, të dhëna fiskale)

- Integrimi teknik me sistemin "Lince" dhe "Ad.El"

- Testimi i integritetit në mjedisin e testimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

- Testimi i skenarëve kryesorë: faturë cash, faturë noncash, faturë korrigjuese, modalitet offline dhe sinkronizim

- Kalimi në mjedisin Live dhe verifikimi i transaksioneve të para reale

Detyrimet e Operatorit të Shërbimit

Gjatë gjithë periudhës kontraktuale, operatori i shërbimit detyrohet të:

- Vëre në dispozicion sistemin e fiskalizimit të gatshëm, të certifikuar dhe të integruar me sistemin "Lince" dhe "Ad.El", brenda afatit të parashikuar.

- Ofrojë mbështetje teknike për çdo problem që lidhet me funksionimin e sistemit të fiskalizimit.

-
- Kryejë trajnimin fillestar të personelit të Tirana Parking sh.a. për përdorimin e saktë të sistemit.
 - Ofrojë përditësime të sistemit pa kosto shtesë, nëse gjatë periudhës kontraktuale ndryshon legjislacioni ose specifikimet teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
 - Njoftojë Tirana Parking sh.a. me shkrim dhe në kohë të arsyeshme për çdo ndryshim të planifikuar të sistemit.

Detyrimet e Tirana Parking sh.a.

Tirana Parking sh.a. gjatë periudhës kontraktuale detyrohet të:

- Sigurojë aksesin teknik të nevojshëm në sistemin "Lince" dhe "Ad.El" dhe infrastrukturën IT për realizimin e integritetit.
- Garantojë lidhje aktive interneti në të gjitha pikat e parkimit ku operon sistemi i fiskalizimit.
- Sigurojë që stafi operativ i Tirana Parking sh.a. të përdorë sistemin e fiskalizimit në mënyrë të saktë dhe rigorozë, duke pasqyruar me besnikëri çdo transaksion të kryer dhe duke garantuar saktësinë e të dhënave të përdoruesve dhe të faturave të lëshuara, në plotësim të detyrimeve ligjore të tatimpaguesit.
- Njoftojë menjëherë operatorin e shërbimit në rast të çdo problemi teknik ose mospërputhjeje të vërejtur në funksionimin e sistemit.

Periudha e shërbimit dhe vlera e kontratës

Shërbimi do të ofrohet për një periudhë **1** (një) vjeçare nga data e nënshkrimit të kontratës, duke përfshirë brenda kësaj periudhe vënien në punë, testimin, integrimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit.

Afati i lëvrimit për procedurën duhet të jetë **60** (gjashtëdhjetë) ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të **3 (tre) viteve të fundit** financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. (Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivitet).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 27001 - 2022** ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, (te vlefshme).

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në këtë procedure, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë certifikata “ISO” të rënditura më lart, sipas zërave të shërbimeve/mallrave, që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes midis palëve.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar të paktën 1 (një) ose më shumë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të siguar për 3 (tre) muajt e fundit dhe të kualifikuar me njohuri të kombinuara si më poshtë, i cili të plotësojë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:

- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimit “CAME PARKARE”
- 1 (një) specialist i certifikuar për sistemet e parkimeve “AD.EL Srl”

-
- 1 (një) specialist i çertifikuar për konfigurime ne server
 - 1 (një) specialist i çertifikuar për te administruar databaza

Për të dëshmuar përmbushjen e kritereve sa më sipër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Çertifikatat /Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuar nga subjekte të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vëndi i origjinës, për secilin specialist/ekspert të kualifikuar.
- CV e punonjësit.
- Listëpagesa sipas formularit eSig25, për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

